



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK

Nr. 8024/prot.

Himarë, më 27.10. 2025

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së rradhës të Këshillit Bashkiak Himarë.

Të nderuar këshilltarë,

Ju njoftojmë se ditën e premte më datë 31.10.2025, ora 10:30 në sallën “Neço Muko” Himarë do të zhvillohet mbledhja e radhës për muajin tetor të Këshillit të Bashkisë Himarë, e thirur nga Kryetari i Këshillit, në bazë të pikës 4, të nenit 53, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar. Mbledhja do të ketë këtë rend dite.

Miratimi i rendit të ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për dhënien e miratimit në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 2.09 Ha, dhe një sipërfaqe tjetër për impiant betoni prej 945 m², në Palasë, zona kadastrale 2863, në favor të shoqërisë “Dulla Konstruksion Sh.p.k”;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores të komisionit këshillimor për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Himarë”;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për zbatimin e VKM-së nr. 329, datë 22.05.2019”;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për themelimin e shoqatës sportive jofitimprurëse, Klubi i Sportit Himara, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për propozimin për dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 01-30 shtator 2025, nga fondi i kushtëzuar 6% i bllok ndihmës ekonomike;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit “Për miratimin e vendimit të depozitimit dhe sistemimin e mbetjeve të ngurta në zonën e Vishës;
7. Të ndryshme.



Sekretari

Zaho Dedi